



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:261155

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05637029

KPPP.nr.2020/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbare të kreditorit “Shtëpia Filmike Dielli” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, rruga “Rexhep Krasniqi”, me NUI: 811358979, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Asman Hoxha avokat me seli të zyrës në Prizren, kundër debitorit “Lenti & Armkos Group” Sh.P.K., me seli në Prizren, rruga “De Rada” pn, me NUI: 811346669, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbare P.nr.582/2023 të datës 01.11.2023, të nxjerrë nga Përmbaresi Privat Liridon Tërshani me seli të zyrës në Prizren, jashtë seancës me datë 26.04.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “Lenti & Armkos Group” Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.582/2023 të datës 01.11.2023, të nxjerrë nga Përmbaresi Privat Liridon Tërshani, dhe i njejtë Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.
- II. Detyrohet debitori që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi t’ia paguaj kreditorit shpenzimet e procedurës në këtë gjykatë sipas prapësimit të debitorit në shumë të përgjithshme prej 104 €, në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim nga avokati.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, me Urdhri Përmbaresimor P.nr.582/2023 të datës 01.11.2023, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, e ka caktuar përmbaresimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm–faturës Nr.3101/23 të datës 31.01.2023, me të cilin ka urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit të këtij urdhri, t’ia paguaj kreditorit tërësisht borxhin, në shumën prej 6,000.00 Euro, me kamatëvonesë prej 8 % vjetore nga data e afatit për pagesë të faturës deri në pagesën përfundimtare, si dhe të gjitha shpenzimet e përmbaresimit, nën kërcënim të përmbaresimit të dhunshëm.

Kundër urdhrin të Përmbaresit Privat, debitori ka ushtruar prapësim me arsyetimin se dokumenti i besueshëm mbi të cilin është lëshuar urdhri përmbaresimor nuk i përmban asnjë nga elementet për të qenë dokument i besueshëm, pasi fatura mbi të cilën është lëshuar urdhri nuk është obligim i krijuar. Më tej ka theksuar se kreditori ka dështuar t’ia sjellë debitorit raportin dhe dokumentacionet në bazë të nenit 14 par.2 të Ligjit Nr.05/L-090 për Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të cilat do të mund t’i procedonte në ATK brenda 30 dite, dhe në mungesë të tyre, tashmë është e pamundur që ky sponsorizim të rimburohet në ATK. I ka propozuar gjykatës që prapësimi të aprovohet në tërësi si i bazuar ndërsa urdhri përmbaresimor i Përmbaresit Privat të anulohet dhe të shfuqizohen të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me përmbaresimin, si dhe të detyrohet kreditori të paguaj shpenzimet e paraqitjes së prapësimit sipas tarifës së OAK-së, në shumën prej 156.00 Euro.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka deklaruar se prapësimi i debitorit është bërë sa për të zvarritur kohën dhe për të rritur shpenzimet, duke shtuar se debitori nuk ka bashkangjitur asnjë provë materiale që parashihet me nenin 69 par.4 të LPP-së. Më tej ka theksuar se fatura i përmban të gjitha elementet që kërkohen me dispozitat ligjore dhe nuk ka asgjë të paqartë në propozimin për përmbaresim, ngase fatura është në origjinal dhe është pranuar, nënshkruar dhe vulosur nga debitori. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet, ndërsa urdhri P.nr.582/23 i datës 01.11.2023 të mbetet në fuqi, si dhe të obligohet debitori të paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës përmbaresimore, për përgjigje në prapësim shumën prej 208 Euro, si dhe shpenzimet tjera që krijohen gjatë procedurës përmbaresimore.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit, dhe pas analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata, nga shkresat e lëndës, ka evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarim dokumentin e besueshëm/faturën Nr.3101/23 të datës 31.01.2023, me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura e lartcekur përmban të gjitha elementet të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37 për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e njehta është dorëzuar në origjinal dhe është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt i cili vërtetohet me vulën dhe nënshkrimin e debitorit.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 452 par. 1 dhe 463 par.1 dhe 2 të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së. Gjykata e gjeti si të bazuar kërkesën e kreditorit për pagesë të shpenzimeve sa i përket përpilimit të përgjigjes në prapësim, ndërsa lartësinë e saj gjykata e llogariti duke u bazuar në Rregulloren për Tarifën e Odës së Avokatëve të nxjerrë nga

Oda e Avokatëve më 18 mars 2017, siç përcakton neni 453 par.2 LPK-së lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, ashtu që si bazë u mor lartësia e vlerës së përmbartimit, numri i palëve të përfaqësuar, si dhe lloji i veprimit procedural për të cilin janë kërkuar shpenzimet.

Në kuptim të nenit 73 të LPP-së, gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2020/23, me datë 26.04.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.